

AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ZOOM.AL” Shpk

Ne Tirane, sot me date 01 dhjetor 2022, me cilesine e “ortakeve themelues” ne:

- **ALFRED TOLLJA** shtetas Amerikan, i biri i Asllan, lindur ne Peshkopi, me 17.11.1974, ne adresen: Rr. “Rruga Hoxha Tahsim Nr. 52/1, Tirana 1000, Albania, Tirane, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, mbajtes i pasaportes me numër **529414818**,

me vullnet të lire, të plote e të sinqerte, mbeshtetur ne :

Kushtetuten e Republikës se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “ Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare “ te ndryshuar me ligjin 129/2014, ne ligjin 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Bizneseve”, ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, kemi krijuar shoqerine me perjegjesi te kufizuar me emerimin **“Zoom.al” Shpk** (me poshte e quajtur “Shoqeria”)

KREU I

Neni 1
Krijimi

Shoqeria **“Zoom.al” Shpk**, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me perjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria **“Zoom.al” Shpk**, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortaket i vetem”, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortaket përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaket gjëzojne kuotën e tyre në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3
Selia

Shoqeria e ka seline kryesore ne Tirane, ne adresen : Rr. Rruga Hoxha Tahsim Nr. 52/1, Tirana 1000, Albania, Tiranë, Shqipëri”.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakeve.

Neni 4
Objekti i veprimtarise

Veprimitari ne fushen e mediave te shkruara dhe online, hapjen dhe mirembajtjen e faqeve te internetit. Botimi, prodhimi dhe shperndarja e revistave gazetave, materialeve te tjera te lejuara me ligj. Konsulencë



ne fushen mediatike. Përvec kesaj ne perputhje me legjislacionin shqiptar, shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet që lidhet direkt ose indirekt, që eshte rezultat ose lidhet me objektivin e mesiperme

Neni 5 Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per një periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

KREU II KAPITALI

Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10.000 lekë.

Kapitali i mesiperme eshte nënshkruar dhe shlyer teresisht ne te holla nga "Ortaket" e shoqerise :

Z.Alfred Tollja, eshte zoterues i 1 kuote me vlerë 10,000 leke, e cila perfaqeson 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi i ortakett mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta) Ortaket per gjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7 Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit te një eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakett te Vetem në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Bizneseve për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Bizneseve".

Neni 8 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te tij ne Qendren



Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU II ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarres

Ortaket i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaket i Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te peraktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaket i vetem, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërbërimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese;
- Të gjitha vendimet e marra nga ortaket i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) investime;
 - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10

Administrimi

Administrator i shoqerise eshte Znj. Denisa Skodi, e bija e Adem, shtetase Shqiptare, lindur ne elbasan me 14.07.1996 me numer personal J65714082E.

Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat 1 vit me te drejte riperteritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortaku i shoqerise. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person i trete jashte ortakerise.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortaket i vetem;



- b) përfaqësojë shoqerinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimitarësë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë ortakët te vetem për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrëthanat, që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimitarësë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimitarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakët te vetem edhe ne rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston reziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuarë,

Administratori ka të drejtë të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përparrë të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet e shtetërore Shqiptare apo të huaja, Bankave te te gjitha niveleve, zyrate te tatim taksave, autoritetet doganore, përfshi këtu edhe autoritetet gjyqësore të gjitha shkallevet. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojet ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoroni këtë akt në rrëthanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Pergjegjesite

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojet e marrëveshjeve të pamiratuar nga Ortaket i Vetem që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakët që ka bërë marrëveshjen, për të përbaluar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojet përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarësë së shoqërisë në mëdës;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arrijen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përfjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
 3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara.

Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare. 4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprintarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Bizneseve dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 14

Bilanci i shoqerise dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vittit financiar, Mbledhja e Ortakett te Vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakett te Vetem vendos ireth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vittit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 16

Dispozita perfundimtare

Ky Akt themelimi i shoqerise "Zoom.al" shpk, u redaktua nga une "Ortaket Themelues" ne 4 ekzemplare me vlera te njejtë juridike ne gjuhen shqipe me permbajtje dhe vlera te njejtë juridike.

ORTAKET

"Zoom.al" Shpk

ALFRED TOLLJA

